

**Emër Mbiemër:** Adem Bunguri  
**Datëlindja:** 10.03. 1954  
**Vendlindja:** Grevë/Peshkopi  
**Viti i zgjedhjes:** 2023  
**Seksioni:** Shkencat shoqërore dhe Albanologjike  
**Gjuhët e huaja:** Anglisht (me dëshmi)



---

## **Kontakt**

**Adresa:** Lagjia “Kinostudio”, Rruga “A. Moisiu”, Pall. Mona, Shk. II, Ap. 4.  
Njësia administrative nr. 4.  
Tiranë  
Tel. ++355 67 26 72 355  
E-mail: "[bunguria1@gmail.com](mailto:bunguria1@gmail.com)"

---

## **CV e shkurtër:**

Studiues i Arkeologjisë Prehistorike, Drejtues Kërkimesh, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Vlerësohet për maturinë shkencore dhe për formulimin e përgjithësimeve të rëndësishme lidhur me qytetërimet prehistorike të Shqipërisë dhe të Kosovës. Është pjesëmarës, drejtues dhe bashkëdrejtues i më shumë se 60 ekspeditave arkeologjike në terren kryesisht në Shqipëri dhe Kosovë, si dhe në Maqedoninë e Veriut (Dibër-Pollog), është bashkëdrejtues i disa projekteve shkencore të realizuara në Shqipëri në bashkëpunim me shkollat arkeologjike europiane (Gjermani, Itali, Poloni, Greqi). Ka botuar mbi 70 artikuj shkencorë në revista arkeologjike në Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kosovë, Slloveni, Gjermani Greqi, Poloni dhe Britani (Cambridge, Oksford). Është autor dhe bashkëautor i 8 monografive shkencore. Ka marrë pjesë në disa kongrese ndërkombëtare të Arkeologjisë Prehistorike (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Slloveni, Francë, Greqi, Turqi, Gjermani, Poloni, Itali, Britani) etj. Kontributet më të rëndësishme të punës së tij janë: formulimi i hipotezës mbi modelet e ndyshme të neolitizimit të territorit të Shqipërisë, hipotezës mbi rrugët dhe modulet e indoeuropianizimit të Shqipërisë dhe të Kosovës, evidentimi i metalurgjisë prehistorike në Shqipëri dhe Kosovë dhe përcaktimi i provincave të pavarura metalurgjike gjatë Eneolitit dhe Bronzit të Vonë në këto hapësira gjeo-kulturore etj. Interesat e tij shkencore janë përqëndruar në studimin e kulturës së epokës së Bronzit në Shqipëri dhe në Kosovë, të lidhur ngushtë me proceset e formimit etno-gjenetik të popullsisë ilire në Ballkanin Perëndimor. Ka formuluar dhe argumentuar në pikëpamje shkencore për të parën herë hipotezën anatoliane të migracioneve të Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, në kundërshtim me hipotezën e migracionit “kurgan”, që ka mbizotëruar deri vonë në arkeologjinë prehistorike shqiptare. Është hartues i programeve arkeologjike të nivelit “Master” dhe “Doktoraturë”, drejtues i mjaft diplomave të nivelit “Master” dhe udhëheqës i disa tezave doktorale. Është organizues dhe drejtues i Konferencës Ndërkombëtare Prehistorike të Maliqit, në kuadrin e 70 vjetorit të

Arkeologjisë shiptare (Maliq 2018). Është laurat i çmimit të parë “**Dea Dardanicae**”, (Kosovë 2018). Mban titullin “**Mjeshtër i Madh**” (2021) dhe “**Qytetar Nderi**” i Peshkopisë” (03.03.2023).

---

### **Publikime (Monografi, Vepra kolektive, Përmbledhje studimesh)**

#### **Autor:**

1. “Prehistoria e Dibrës”, Tiranë 2010.
2. “Vegla bakri dhe sēpata bronzi në Shqipëri dhe Kosovë”, Tiranë 2021.
3. “Përkrenare ilire në Shqipëri dhe Kosovë”, Tiranë 2022

#### **Bashkëautor (F.Prendi-A. Bunguri)**

1. «Bronzi i Hershëm në Shqipëri» («The Early Bronze Age in Albania») Prishtinë 2008.
2. «Studime për Prehistorinë e Shqipërisë», Tiranë 2014.
3. «Studies in the Prehistory of Albania», Tiranë 2018.

#### **c. Editues & botues (Adem Bunguri-Shafi Gashi)**

1. F. Prendi, “Studime Arkeologjike”, I (Përmbledhje artikujsh në gjuhën shqipe), Prishtinë 2008.
2. F. Prendi, “Archaeological Studies”, II (Përmbledhje artikujsh në gjuhë të huaja). Prishtinë 2008.
3. F. Prendi, "Vendbanimi prehistorik i Maliqit" ("The prehistoric Settlement of Maliq"), Tiranë 2018.
4. S. Islami, “Kultura ilire e tumave të Matit”, Prishtinë 2013.

#### **d. Botime me grup autorësh:**

1. «Harta Arkeologjike e Kosovës», I, Prishtinë 2006.
2. «Harta arkeologjike e kosovës», II, Prishtinë 2012.
3. «Katalog Arkeologjik i Kosovës», Prishtinë 2013.
4. "Recent Archaeological Discoveries in Albania", Tiranë 2013.